



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 168

Tiranë – E martë, 10 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 138/2019, datë 5.12.2019	Për zgjedhjen e zotit Olsian Çela Prokuror i Përgjithshëm..... 13037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 6.11.2019	Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi..... 13037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 6.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar..... 13038



VENDIM
Nr. 138/2019

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT OLSIAN
ÇELA PROKUROR I PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të nenit 148/a të Kushtetutës dhe të nenit 35, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Olsian Çela zgjidhet Prokuror i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.12.2019

VENDIM
Nr. 780, datë 6.11.2019

PËR CAKTIMIN E OFICERËVE
KOORDINUES PËR ÇËSHTJET E
DIASPORËS SHQIPTARE NË
KONSULLATAT SHQIPTARE NË ITALI
DHE GREQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare pranë posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

– 1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë;

– 1 (një) oficer koordinues për diasporën për

çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi;

– 1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Milano, Itali;

– 1 (një) oficer koordinues për diasporën për çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Selanik, Greqi.

2. Oficerët koordinues do të ushtrojnë funksionin e tyre sipas fushave të mëposhtme:

a) zhvillimi i marrëdhënieve me komunitetet shqiptare në shtetin pritës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës;

b) identifikimi i nevojave për arsimimin dhe komunikimi me mësuesit e programeve plotësuese të gjuhës e të kulturës shqiptare në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën;

c) nxitja dhe organizimi i bizneseve shqiptare në vendin pritës në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës;

ç) identifikimi dhe asistimi i shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për drejtësinë.

2.1 Përshkrimi i punës, detyrat kryesore dhe mënyra e komunikimit përcaktohen në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe institucionit propozues. Marrëveshja duhet të përmbajë:

a) pozicionin e punës dhe gradën e emërimit;

b) përshkrimin e punës;

c) afatin e punësimit;

ç) të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit.

3. Oficerët koordinues për çështjet e diasporës shqiptare emërohen nga ministri përgjegjës për punët e jashtme pas bashkëpropozimit të ministrit përgjegjës të fushës që do të mbulojë oficeri dhe ministrit përgjegjës për diasporën. Oficerë koordinues të diasporës mund të përzgjidhen edhe nga jashtë Shërbimit të Jashtëm, të cilët zotërojnë njohuri dhe ekspertizë të spikatur në fushën e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

5. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe



ministritë e tjera të linjës, sipas fushave që do të mbulojnë rast pas rasti oficerët koordinues, referuar fushave të parashikuara në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 781, datë 6.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE
PËRDORIMIN E FONDIT TË
VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet, si më poshtë vijon:

“9. Përgjashtimisht për vitin 2019, fondi i veçantë i institucioneve qendrore, buxhetore dhe jobuxhetore, institucioneve të vetëqeverisjes vendore, njërive të fondeve speciale, institucioneve publike, të krijuara me ligj të posaçëm, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, në varësi të institucioneve qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore, nuk do të përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve.”.

2. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë